



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Prill 2021

Nr: 13

UDHËZIM

PËR

**MËNYRËN E PASQYRIMIT TË RAPORTIT TË MBYLLJES SË IDENTIFIKIMIT
ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE NGA PAJISJA E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË
ZGJEDHËSVE (PEI), NË QENDRËN E VOTIMIT, NË TË CILËN PRINTIMI ËSHTË I
PALEXUESHËM**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

U D H Ë Z O J M Ë:

1. Menjëherë pasi operatori teknik i QV-së ka mbyllur procesin e identifikimit të zgjedhësve në qendrën e votimit (QV), PEI printon raportin e mbylljes, i cili përmban:
 - a) Qarkun;
 - b) Bashkinë;
 - c) numrin e zonës së administrimit zgjedhor;
 - ç) numrin e qendrës së votimit;
 - d) orën e printimit të raportit;
 - dh) numrin serial të pajisjes PEI;
 - e) numrin e zgjedhësve në listën e QV-së;
 - ë) numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht, duke specifikuar:
 - i. numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht të ndarë sipas gjinisë;
 - ii. numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht pa gjurmë të gishtërinjve



- iii.numrin e rasteve të veçanta të identifikimit të zgjedhësve (zgjedhës me vendim gjykatë, administratë zgjedhore);
- f) numrin e tentativave për votim të dyfishtë;
- g) numrat rendorë të zgjedhësve të identifikuar elektronikisht në listën e zgjedhësve;
- gj) numrin e zgjedhësve që nuk janë paraqitur për votim.
2. Nëse raporti i mbylljes së procesit të identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), printohet me ngjyre të zbehtë, me viza, i zbardhur tërësisht apo i palëxueshëm disa apo të gjithë elementët përbërës të tij sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, komisioni i qendrës së votimit (KQV-ja) mban procesverbal ku shënon të gjitha të dhënat e shfaqura në ekran.
3. Procesverbali i mbajtur nga KQV-ja nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së, vuloset nga Sekretari me vulën e KQV-së dhe administrohet nga Kryetari i KQV-së.
4. Ngarkohen anëtarët e KQV-ve për zbatimin e këtij udhëzimi.
5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

